

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6506
E hënë, 10 janar 2022
çmimi 0.40

Ambasadori i ri amerikan mbërrin në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JANË MOBILIZUAR PAS RRRITJES SË RASTEVE
TË REJA ME COVID-19

FAQE 4-5

62 PËR QIND E QYTETARËVE NË KOSOVË JANË VAKSINUAR ME TË DYJA DOZAT E VAKSINËS KUNDËR COVIDIT



Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka treguar të dielën për të dhënat e vaksinimit të qytetarëve me vaksinat kundër Covid-19. Sipas MSh-së, mbi 70 për qind e qytetarëve janë vaksinuar me dozën e parë dhe 62 për qind me dozën e dytë të vaksinës, duke e cilësuar Kosovën një nga vendet më të larta të rajonit për nga përqindja e vaksinimit. Ditët e fundit janë rritur rastet e infektimit me Covid në Kosovë. Të dielën janë konfirmuar 304 raste të reja me këtë virus. Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka kërkuar që klinikat e QKUK-së të jenë të gatshme për t'u ballafaquar me virusin Covid-19

AKTUALE



**MBI 5 000 TË ARRESTUAR NË
KAZAKISTAN**

F. 2

**POLICIA KONFISKON PAJISJE PËR
PRODHIMIN E KRIPTOVALUTAVE**

F. 6

**SOT FILLON GJYSMËVJETORI I
DYTË**

F. 6

EKONOMI



**RUKIQI: VITI 2022 DO TË
JETË I VËSHITËRË, DO TË KETË
PROBLEM ME SIGURIMIN
E FUQISË PUNËTORE**

F. 7

**PSE PO BIEN ÇMIMET
E KRIPTOVALUTAVE?**

F. 7

SPORT



**BASHA: SYNOJ TË SHKOJ
LARG SI TRAJNER**

F. 11

Në Kosovë në të zezën, në Serbi me adresë të pasivizuar

FAQE 3



HARADINAJ, KURTIT: MBI 50 MIJË QYTETARË BRENDA NJË MUAJI APLIKUAN PËR VIZA PUNE, PSE PO HESHT?

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbi 5 000 të arrestuar në Kazakistan

NURSULTAN, 9 JANAR - Më shumë se 5 000 njerëz janë arrestuar në Kazakistan lidhur me trazirat që kanë tronditur vendin më të madh të Azisë Qendrore javën e fundit, u cituan të kenë thënë autoritetet kazake të dielën.

Në total, 5 135 persona janë arrestuar për t'u marrë në pyetje si pjesë e mbi 100 hetimeve të veçanta që lidhen me trazirat, sipas Ministrisë së Brendshme të këtij shteti.

Kazakistan, një vend i pasur me energji dhe me rreth 19 milionë banorë, është tronditur javën e kaluar nga trazirat që u përhapën në qytete të ndryshme të vendit e ku u vranë dhjetëra persona duke përfshirë civilë dhe forca të rendit.

Rritjet e çmimit të karburantit shkaktuan trazira një javë më parë në zonat provinciale perëndimore, por ato arritën shpejt në qytetet më të mëdha, duke përfshirë qendrën ekonomike Almaty, ku shpërthyen trazirat dhe policia hapi zjarr duke përdorur plumba drejt protestuesve.

Dëmet e trazirave

Ministria e Brendshme e Kazakistanit, e cituar të dielën nga media lokale, tha se vlerësimet fillestare tregojnë se dëmi i shkaktuar ndaj pronës shtetërore dhe private është rreth 175 milionë euro.

Më shumë se 100 biznese dhe banka u sulmuan dhe

plaçkitën dhe më shumë se 400 automjete u shkatërruan, citohet të ketë thënë ministria e Brendshme e Kazakistanit. "Sot situata është stabilizuar në të gjitha rajonet e vendit", tha ministri i Brendshëm Erlan Turgumbayev, duke shtuar se operacioni kundër terrorizmit po vazhdon në një përpjekje për të rivendosur rendin në vend.

Një qetësi relative u duk se po kthehej në Almaty, me policinë që ndonjëherë qëllonte në ajër për t'i ndaluar njerëzit që i afroreshin sheshit qendror të qytetit, raporton AFP.

Përkundër faktit se forcat e rendit kanë vënë nën kontroll situatën, tashmë kanë filluar arrestimet e zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të këtij shteti nën akuzat për "tradhti të rëndë".

Të shtunën u raportua se autoritetet kazake arrestuan ish-kreun e Komitetit të Sigurisë Kombëtare me dyshimin për tradhti.

Karim Massimov, i cili u shkarkua këtë javë nga ky organi i rëndësishëm i inteligjencës, u arrestua së bashku me disa zyrtarë të tjerë, emra e të cilëve nuk u publikuan.

Trazirat filluan si përgjigje ndaj një rritjeje të çmimit të karburanteve, por u shndërruan në një lëvizje të gjerë kundër qeverisë së presidentit Kassym-Jomart Tokayev i cili mbështetet nga Rusia dhe ishte presidenti



Nursultan Nazarbayev, familja e të cilit besohet se gjerësisht ka ruajtur ndikimin në Nur-Sultan.

ShBA kundër trupave ruse

Me kërkesë të presidentit të Kazakistanit, një aleancë ushtarake e udhëhequr nga Rusia u vendos në Kazakistan gjë që nxiti reagime të shumta nga Perëndimi, në veçanti nxiti reagimin e ShBA-së.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se Shtetet e Bashkuara kanë disa pyetje sa i takon kërkesës së Kazakistanit për ndihmë nga organizata e sigurisë, e udhëhequr nga Rusia.

Blinken tha se autoritetet kazake "kanë kapacitet për t'u

përballur me protestat" në atë mënyrë që do të respektoheshin të drejtat e protestuesve dhe në të njëjtën kohë duke vënë rend dhe ligj. "Prandaj nuk është e qartë pse ata e ndien të nevojshme për të kërkuar ndihmë nga jashtë, dhe ne jemi duke u munduar që të kuptojmë më shumë për këtë gjë", tha Blinken gjatë një konference për medie më 7 janar në Departamentin e Shtetit.

Mediet lokale në Kazakistan raportuan se deri më tani të paktën 13 zyrtarë të zbatimit të ligjit vdiqën në qytetin Almaty dhe 353 persona u plagosën, por numri i protestuesve të vranë në trazira ende nuk është i qartë.

Më shumë se 1 000 njerëz në rajone të ndryshme u plagosën si pasojë e trazirave. Prej tyre, pothuajse 400 u shtruan në spital, me 62 persona në kujdes intensiv, citohet të ketë thënë Ministria e Shëndetësisë e Kazakistanit.

Rreth 254 mijë izraelitë marrin dozën e katërt të vaksinës

Jerusalem, 9 janar - Rreth 254 000 izraelitë kanë marrë një dozë të katërt përforcuese të vaksinës kundër Covid-19. Ky numër kaq i lartë i qytetarëve që kanë marrë dozën e katërt të vaksinës u arrit vetëm brenda pak ditësh prej kur autoritetet izraelite njoftuan se qytetarët mund ta marrin dozën e katërt, tha të dielën, më 9 janar, Ministria e Shëndetësisë në Izrael, derisa ky vend po përballet me një rritje të infeksioneve për shkak të

variantit Omicron.

Deri më tani vetëm personat mbi 60 vjeç, personat me sëmundje kronike dhe ata me sistem imunitar të dobët kanë të drejtë për të marrë një dozë të katërt të vaksinës kundër Covid-19.

Kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, vlerësoi të dielën marrjen e lartë të vaksinës nga grupet e rrezikuara si "një përgjigje të jashtëzakonshme që do të parandalojë sëmundje shumë të rëndë dhe vuajtje".

Për shkak të përhapjes së variantit Omicron, Izraeli ka parë një rritje të paprecedentë të infeksioneve të reja ditore, duke regjistruar më shumë se 17 500 raste të dielën.

Mediet raportojnë se duke parë rritjen drastike të rasteve të infektimit edhe të personelit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë së Izraelit po shqyrton mundësinë e lejimit të mjekëve dhe infermierëve që të vazhdojnë të punojnë edhe kur rezultojnë pozitivë me koronavirus për sa kohë që ata nuk shfaqin asnjë simptomë.

Izraeli u vlerësua në të kaluarën si një model për përpjekjet e tij të vaksinimit, megjithatë fushata ka stagnuar.

Vetëm rreth 61 për qind e 9.4 milionë izraelitëve konsiderohen ende të vaksinuar, që do të thotë se ata janë vaksinuar me të dyja dozat dhe kanë kaluar më pak se gjashtë muaj pas vaksinimit të dytë, ose kanë marrë një dozë përforcuese.

Rreth 30 për qind e popullsisë nuk janë fare të vaksinuar dhe për rreth 9 për qind, vlefshmëria e vaksinimit tashmë ka skaduar.



Në Kosovë në të zezën, në Serbi me adresë të pasivizuar



PRISHTINË, 9 JANAR - Sedat Ajvazi me prejardhje nga Lugina e Preshevës jeton në Kosovë që nga muaji qershor i vitit 1999. Për më shumë se 22 vjet ai thotë se e ka pasur të pamundur që ta fitonte nënshtetësinë apo të pajisjes me ndonjë dokument të Kosovës. Sedati nuk ka as dokumente valide të Serbisë, pasi autoritet serbe atje i kanë pasivizuar adresën. "Aktualisht unë jam në Kosovë person në të zezën. Nuk mund të më verifikojë as Policia e Kosovës e as Policia e Serbisë. Dokumentet e Serbisë i kam pa afat, do të thotë ato sistemi nuk i pranon për shkak të pasivizimit atje. Të Kosovës nuk kam kurrfarë dokumenti edhe pse jetoj në Kosovë që nga qershori 1999", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Sedati thotë se shumë herë ka mbledhur dokumentacione, me shpresë se një ditë institucionet e Kosovës do ta pajisin me leje qëndrimi apo me dokumentacione të përkohshme. Kërkesën e parë thotë se e kishte bërë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2001, por kërkesa i ishte refuzuar për shkak se nuk kishte mundur ta dëshmonte se ka jetuar në Kosovë para viteve '98-99. "Tri herë kam qenë në Ministri të Punëve të Brendshme të Kosovës te Zyra për të Huajt dhe kërkesa më është refuzuar për shkak të mungesës së kontratës së punës sepse unë nuk munda të lidh kontratë pune me dokumentacione sa ishin valide ato të Serbisë. Neve na kërkohet të kemi sigurim shëndetësor që as qytetarët e Kosovës nuk e kanë. Na kërkohet kontrata e punës me minimum të pagës 500 euro", thotë Sedati.

Problemet me të cilat është përballur Sedati për më shumë se

22 vjet po tentohen që të zgjidhen përmes një iniciative të Qeverisë së Kosovës, e cila më 29 dhjetor të vitit të kaluar miratoi konceptdokumentin për shtetësinë.

Në këtë koncept-dokument, siç ka bërë me dije këshilltari i presidentes së Kosovës, Artan Murati, është përfshirë komenti dhe propozimi i Zyrës së Presidentes, i cili do t'ua mundësojë shqiptarëve nga Medvegja, Presheva e Bujanoci të pajisen me shtetësi të Republikës së Kosovës.

Iniciativa për t'i pajisur me shtetësi shqiptarët e Luginës

Në konceptdokumentin për shtetësinë në mënyrë specifike përmenden qytetarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit - komuna në jug të Serbisë, që njihen me termin Lugina e Preshevës - dhe problemet me të cilat ata përballen në përpjekjet e tyre për t'u pajisur me shtetësi të Kosovës. "Të gjithë qytetarët nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të cilët kanë qëndruar në Republikën e Kosovës së paku pesë vjet nga data 12.06.1999 deri më 31.12.2021, do të kenë të drejtën e fitimit të shtetësisë bazuar në rregullimin e kornizës ligjore me këtë konceptdokument, ndërsa sa iu përket kriterëve procedurale do të rregullohet me akte nënligjore", thuhet në konceptdokumentin për shtetësinë të datës 29 dhjetor 2021.

Megjithatë, për të fituar shtetësi çdo qytetar i Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit duhet t'i përmbushë një sërë kriteresh, siç është dëshmia e qëndrimit në

Kosovë prej së paku pesë vjetësh, posedimi i lejes së vlefshme të qëndrimit, pranimi i rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës, posedimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për të jetuar në Kosovë, përmbushja e detyrimeve financiare ndaj shtetit si dhe shumë kritere të tjera.

Antigona Shaipi me prejardhje nga Presheva ka kaluar nëpër një proces të gjatë derisa ka arritur që ta fitojë shtetësinë e Kosovës. Që nga fëmijëria ajo ka jetuar në qytetin e Gjilanit në Kosovë. "Procedura për ta fituar shtetësinë e Kosovës ishte një procedurë shumë e gjatë, e cila kryesisht zgjat pesë vjet në bazë të plotësimit të kriterëve, por unë pasi kisha përfunduar gjithë arsimimin në Kosovë që nga shkolla fillore e deri tek universiteti, procedura u shkurtua nga pesë në dy vjet", thotë ajo për "Radion Evropa e Lirë".

Antigona tregon se fillimisht është pajisur me leje qëndrimi njëvjeçar, pastaj është pajisur me shtetësinë kosovare, kur edhe ka nxjerrë letërnjoftimin. Por, procedura për familjarët e saj ishte më e gjatë dhe më e mundimshme, thotë ajo. "Procedura ishte më të vërtetë e gjatë dhe shumë e kushtueshme, pasi që dihet që shumica e dokumenteve kanë afat të vlefshëm vetëm gjashtë muaj dhe kjo procedurë përsëritej çdo vit", tregon Antigona.

MPB-ja: Po krijohen lehtësira për qytetarët e Luginës së Preshevës

Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës

thotë se Ligi i ri për shtetësinë do të zgjidhë shumë problematika, në mesin e tyre edhe çështjen e pajisjes me shtetësi të qytetarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci të cilët jetojnë në Kosovë. "Për qytetarët e komunave Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, të cilët janë shpërngulur në Kosovë nga viti 1999, do të parashihen masa lehtësuese për të fituar të drejtën e shtetësisë", thuhet në përgjigjen e MPB-së.

Me punën e institucioneve të Kosovës, sa i takon pajisjes me shtetësi të qytetarëve të Luginës së Preshevës, nuk është i kënaqur Kushtrim Kadriu nga Lëvizja Qytetare Vatra. Ai thotë se edhe qeveritë e kaluara të Kosovës kishin nisur procedura për lehtësime sa i takon pajisjes me shtetësi kosovare të qytetarëve të Luginës së Preshevës porse, sipas tij, asnjëherë nuk ka pasur ndonjë rezultat. "Ne frikësohemi se edhe kjo është një iniciativë e njëjtë si të kaluarat, pasi këta të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës nuk janë konsultuar fare as me ne që merremi me këtë punë, as me Këshillin Nacional në Bujanoc, Preshevë e as me liderët e as me organizatat atje, do të thotë me askënd fare, e besa as me qytetarët që kanë telashe", thekson Kadriu.

Kadriu thotë se qytetarët e Luginës së Preshevës e kanë të vështirë të pajisen me shtetësi të Kosovës pasi në shumicën e rasteve qytetarëve të kësaj pjese që jetojnë në Kosovë u janë pasivizuar dokumentet nga Qeveria serbe. Kjo, sipas Kadriut, u ka pamundësuar atyre që të nxjerrin ndonjë dokument valid të Serbisë e përmes të cilit ata do ta kishin të mundur të aplikonin

për t'u pajisur me dokumente të Kosovës.

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Ragmi Mustafi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova duhet të merret seriozisht me fatin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës që kanë mbetur pa shtetësi. Ai ua tërheq vërejtjen institucioneve të Kosovës për faktin se, sipas tij, në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc organet shtetërore të Serbisë kanë pasivizuar të paktën 6 000 adresa të shqiptarëve të kësaj ane që jetojnë në Kosovë. "Ne kemi kërkuar që sipas praktikave rajonale që kanë hungarezët, kroatët e kështu me radhë, të gjithë qytetarët shqiptarë të Luginës së Preshevës të pajisen me dokumentacione të Kosovës. Edhe në të kaluarën ka pasur tendenca për ta rregulluar infrastrukturën ligjore të Kosovës në mënyrë që të adresohet kjo çështje, porse zgjidhjet që janë ofruar nuk kanë prodhuar rezultate", shprehet Mustafi.

Mustafi thotë se përmes ndryshimeve ligjore duhet të hiqet çdo pengesë në procesin e pajisjes së shqiptarëve të Luginës së Preshevës me dokumente si dhe me shtetësi të Kosovës.

Sipas organizatave joqeveritare dhe subjekteve politike nga Lugina e Preshevës, në Kosovë jetojnë rreth 20 000 qytetarë që kanë migruar në Kosovë për arsye të ndryshme. Sipas Lëvizjes Qytetare Vatra, shumë prej tyre e kanë pasur të vështirë apo të pamundur që të pajisen me dokumente të Kosovës, pasi u ka munguar një dokument valid i Serbisë, nuk kanë pasur një vend punë në Kosovë, por edhe për shkak se nuk kanë plotësuar kritere të tjera të përcaktuar në Ligjin për shtetësinë.



INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JANË MOBILIZUAR PAS RITJES SË RASTEVE TË REJA ME COVID-19

62 për qind e qytetarëve në Kosovë janë vaksinuar me të dyja dozat e vaksinës kundër Covidit

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka treguar të dielën për të dhënat e vaksinimit të qytetarëve me vaksinat kundër Covid-19. Sipas MSh-së, mbi 70 për qind e qytetarëve janë vaksinuar me dozën e parë dhe 62 për qind me dozën e dytë të vaksinës, duke e cilësuar Kosovën një nga vendet më të larta të rajonit për nga përqindja e vaksinimit. Ndërkaq ditët e fundit janë rritur rastet e infektimit me Covid në Kosovë. Të dielën janë konfirmuar 304 raste të reja me këtë virus. Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka kërkuar që klinikat e QKUK-së të jenë të gatshme për t'u ballafaquar me virusin Covid-19

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 JANAR - Në mars të vitit 202 arritën dozat e para të vaksinës kundër Covid-19 në Kosovë. Që nga ajo kohë e në muajt në vijim, falë profesionistëve shëndetësorë, vullnetarëve dhe partnerëve, është bërë shumë përparim. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se mbi 62 për qind e qytetarëve të moshës së rritur janë vaksinuar. "Më shumë se 70 për qind e qytetarëve të kualifikuar kanë marrë të paktën një dozë, ndërsa mbi 62 për qind e qytetarëve të moshës së rritur janë plotësisht të vaksinuar, dhe

nivelet tona të vaksinimit janë ndër më të lartat në rajon. Ne duam t'i falënderojmë të gjithë ata që kanë ndihmuar për ta bërë të mundur vaksinimin", ka njoftuar MSh-ja. Kjo ministri ka bërë thirrje që vaksinimi të vazhdojë. "Nëse nuk jeni vaksinuar ende, ju lutemi lajmërohuni në qendrën më të afërt të vaksinimit për të marrë vaksinën, dhe kujdesuni që tre muaj pas dozës së dytë ta merrni dozën përforcuese. Bashkë ia dalim andaj, nëse një nga të dashurit tuaj nuk është vaksinuar ende, bisedoni me të dhe shikoni nëse mund të ndihmoni. Le t'i bëjmë ato shifra edhe më të larta dhe le të

vazhdojmë të punojmë së bashku për të mposhtur këtë pandemi", ka theksuar Ministria e Shëndetësisë.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 10 042 testime, 304 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të dielën janë shënuar 3 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 158 134.

Në total numri i rasteve aktive është 1 552.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 2

103 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 692 762 doza të vaksinës.

Deri më sot 789 946 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës janë të shtrirë 14 pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 25 të tjerë post-Covid.

Me oksigjeno-terapi janë 11 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka të shtrirë asnjë pacient.

Ministri Latifi kërkon që klinikat e QKUK-së të jenë të gatshme për t'u ballafaquar me virusin Covid-19

Një ditë më parë ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, me bashkëpunëtorë, ka vizituar Qendrën Klinike Universitare të

Kosovës. Ai vizitoi së pari Klinikën Infektive ku nga drejtori i ShSKUK-së, dr. Valbon Krasniqi dhe drejtori i Infektives, dr. Arben Vishaj, u njoftua për gjendjen aktuale sa iu përket kapaciteteve për trajtimin e pacientëve me Covid-19 si dhe mobilizimin e shërbimeve të tjera.

Aktualisht në këtë klinikë është një numër i vogël i pacientëve me Covid-19 në trajtim, por u vlerësua se numri në rritje i rasteve me Covid-19 mund ta rrisë edhe numrin e pacientëve që kërkojnë trajtim spitalor, për çka të gjitha shërbimet duhet të jenë të gatshme.

Ministri Latifi, që shoqërohej edhe nga sekretari i përgjithshëm i MSh-së, dr. Naim Bardiqi, më pas vizitoi edhe Klinikën Emergjente ku nga personeli aty është njoftuar me punën që bëhet, triazhimin dhe trajtimin e rasteve në këtë klinikë, për të vazhduar pastaj me vizitë në Klinikën e

Ambasadori i ri amerikan mbërrin në Kosovë

PRISHTINË, 9 JANAR - Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Jeff Hovenier, ka mbërritur të dielën në Kosovë. Lajmin e ka bërë me dije i ngarkuari i deritashëm me punë në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë, Nicholas Giacobbe, teksa njoftoi se e ka pritur ambasadorin Hovenier. “Sot mirëprita në Prishtinë ambasadorin e emëruar Jeff Hovenier. Ka qenë një nder të shërbej si i Ngarkuar me Punë gjatë disa muajve të fundit”, ka shkruar Giacobbe në rrjetin

social “Twitter”.

Ambasadori Hovenier njoftoi se do t'i dorëzojë letrat kredenciale gjatë ditës së nesërme. Jeffrey M. Hovenier ka shërbyer si zëvendësambasador i Shteteve të Bashkuara në Ankara të Turqisë.

Nga gushti 2018 deri në korrik 2019 ai ka qenë i ngarkuari me punë në atë ambasadë. Më herët ai ishte zëvendëshef në detyrë i Misionit dhe ministër këshilltar për Çështjet Politike në Ambasadën Amerikane në Berlin të Gjermanisë.



Haradinaj, Kurtit: Mbi 50 mijë qytetarë brenda një muaji aplikuan për viza pune, pse po hesht?

PRISHTINË, 9 JANAR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se për një muaj 56 mijë qytetarë të Kosovës kanë aplikuar për viza pune për të dalë jashtë vendit. Haradinaj e ka pyetur kryeministrin Albin Kurti se a ka ndonjë koment për këtë. “Përse

kjo heshtje? A nuk ishit ju qeveria e shpresës? Përse kaq shumë qytetarë ia mësyjnë ta lëshojnë vendin? Ata duan të ikin sepse qeveria nuk po tregon aftësi për ringjalljen ekonomike, përkundrazi, po e fundos dita-ditës edhe më shumë ekonominë

edhe ashtu në krizë”, ka shkruar Haradinaj në një postim në “Facebook”.

I pari i AAK-së ka thënë se qytetarët po ikin nga vendi sepse kjo qeveri e ky kryeministër po tentojnë që Kosovën ta shndërrojnë në Venezuelë.

“Qytetarët po ikin sepse po ndëshkohen me reduktime të energjisë e fatura të fryra për energjinë që qeveria e blenë po me paratë e tyre, përderisa qytetarëve në veri të vendit ua paguan dhjetëra milionë për energji. Ata refuzuan dhe

shkatërruan mundësinë e artë, që Kosova të bëhet fuqi energjetike në rajon, duke refuzuar edhe Kosovën e re dhe gazin amerikan, veç për të blerë energji me çmime dhjetëfish më të larta nga mafia energjetike”, ka shkruar Haradinaj.



Kardiologjisë, me theks në njësinë e kardiologjisë invazive. Ministri është informuar aty për rritjen e vëllimit të punës, derisa prioritet u tha që mbetet edhe rritja e cilësisë së shërbimeve. Ministri Latifi vizitoi edhe Klinikën e Pulmologjisë ku

aktualisht janë duke u trajtuar disa pacientë post Covid-19 dhe është informuar për punën që është bërë aty gjatë pandemisë, por edhe për trajtimin e patologjive të tjera, përveç Covid-19.

Ministri Latifi ka kërkuar që

klinikat e QKUK-së dhe institucionet e tjera shëndetësore të jenë të gatshme për t'u ballafaquar me çfarëdo zhvillimi të situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19, ndërsa profesionistëve shëndetësorë u

kërkoj që të vaksinohen plotësisht, përfshirë edhe marrjen e dozës përfunduese të vaksinës kundër Covid-19. Ministria e Shëndetësisë, theksoi ministri Latifi, është për t'i mbështetur institucionet dhe për të krijuar kushte sa më të

mira për punë me qëllim që pacientëve t'u sigurohen dhe ofrohen shërbimet e duhura shëndetësore. Gjithashtu, ministri Latifi i ka bërë thirrje edhe popullatës që të vaksinohet plotësisht kundër Covid-19.

Vdesin dy persona në aksident trafiku në Prishtinë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 JANAR- Policia e Kosovës ka njoftuar se dy qytetarë kanë humbur jetën si pasojë e një aksidenti trafiku në rrugën Prishtinë-Podujevë. Sipas Policisë së Kosovës, aksidenti ka ndodhur paraditen e

së dielës rreth orës 9.30. Në këtë aksident të përfshira kanë qenë tri automjete ku të lënduar kanë mbetur edhe nëntë persona të tjerë. “Si pasojë e këtij aksidenti, bazuar në të dhënat fillestare, lëndime trupore kanë pësuar njëmbëdhjetë persona, dy prej të cilëve nuk kanë mundur tu përballojë plagëve të marra dhe të

njëtit, kanë ndërruar jetë. Vdekjen e viktimave e ka konstatuar ekipi mjekësor në vendngjarje”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës. Policia njofton se hetuesit nga njësi i hetimeve të trafikut rrugor në koordinim me prokurorin e shtetit, janë duke u marrë me hetimin e rastit.



Policia konfiskimin e pajisjeve për prodhim të kriptovalutave

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 JANAR- Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla ka njoftuar se Policia e Kosovës ka zhvilluar një aksion për konfiskimin e pajisjeve për mihjen e kriptovalutave në fshatin Trebice të Leposaviqit. “Në këtë aksion në afërsi të fshatit Trebice të komunës së Leposaviqit u konfiskuan 272 nga këto lloj pajisjesh dhe është arrestuar një person. Gjithë aksioni u zhvillua dhe përfundoi pa incidente”, ka shkruar ministri Sveçla në “Facebook”. Ministri Sveçla ka thënë se ky aksion ishte organizuar me qëllim të zbulimit dhe



konfiskimit të pajisjeve për prodhim të kriptovalutave. Siç ka thënë ministri Sveçla aksione të tilla do të vazhdojnë deri “në implementimin e plotë të vendimit të Kuvendit

dhe Qeverisë së Republikës”. Ndërkohë në një komunikatë për media Policia e Kosovës ka njoftuar se në aksion kanë qenë të përfshirë njësi të ndryshme, të cilat e kanë

mbështetur Doganën e Kosovës në kryerjen e kontrolleve në veri. Lloji i pajisjeve të konfiskuara sipas Polcisë së Kosovës është “Antminer” që shërbejnë për prodhimin e kriptovalutës “Bitcoin”. “Mjetet e konfiskuara janë, Antminer S9i 14.0T-128 copë, Antminer S9 13.5T-117 copë, Antminer S9 13.0T- 5 copë, Antminer S9i 14.5T- 19 copë, Antminer S9 10.5T- 3 copë”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës. Së fundmi, Kosova është duke u përballur me krizë energjike, pas rritjes së çmimit të importit të energjisë elektrike. Autoritetet kanë miratuar masa emergjente për energji. Në kuadër të këtyre masave,

Qeveria e Kosovës ka njoftuar të martën, më 4 janar, se institucionet kompetente do të angazhohen që të ndalojnë prodhimin e kriptovalutave, pasi dyshohet se pajisjet me të cilat prodhohen ato, shkaktojnë konsum të lartë të energjisë elektrike. Aktiviteti për prodhimin e kriptovalutave ishte shtrirë së fundi në pjesën veriore të Kosovës për shkak se në atë pjesë, qytetarët nuk e paguajnë energjinë elektrike. Sipas institucioneve të Kosovës, rreth 12 milionë euro në vit llogaritet fatura e përbashkët e energjisë së shpenzuar në katër komuna në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq.

Sot fillon gjysmëvjetori i dytë

PRISHTINË, 9 JANAR- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka njoftuar nxënësit, mësimeve dhe prindërit, se sot, 10 janar 2022, fillon periudha e dytë e vitit shkollor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Task Forcat në nivel komune do të vlerësojnë dhe do të marrin vendime se me cilin skenar do të zhvillohet procesi mësimor bazuar në situatën epidemiologjike me pandeminë në komunat e tyre, si dhe kushtet specifike në shkolla. Drejtoritë Komonale të Arsimit do të kujdesen për respektim të masave të përcaktuara nga IKShPK, të dezinfektojnë hapësirat e shkollave. Përveç mësimit me prani fizike në shkollë, do të jenë në dispozicion edhe mundësitë për

organizimin e mësimin online nëse paraqitet nevoja. Po ashtu, MASHTI, në bashkëpunim me UNICEF, tashmë ka ofruar për të gjitha shkollat mundësinë e qasjes në platformën mësimore eëë.shkollat.org, të bazuar në teknologjinë e Microsoft, ku, përveç sistemit për menaxhimin e mësimin në distancë janë publikuar edhe video-mësimet sipas programit mësimor të klasave 1-9. Megjithatë, shkollat janë të lira të shfrytëzojnë edhe platforma dhe aplikacione të tjera. Ministria e Arsimit fton të gjithë aktorët e përfshirë në shkollë që të respektojnë masat mbrojtëse të përcaktuara nga IKShPK, në mënyrë që ta ruajmë shëndetin publik dhe të kemi mbarëvajtje të procesit mësimor.



Rama në Tiranë, nderohet nga Veliaj me “Çelësin e Qytetit”

TIRANË, 9 JANAR- Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama ka realizuar vizitën e tij të parë zyrtare në Tiranë ku është pritur nga homologu i tij, Erion Veliaj. Rama është pritur me ceremoni zyrtare nga Veliaj, teksa ky i fundit ia dhuroi edhe “Çelësin e Qytetit” për

të cilin tha se është traditë që t’ia japin vetëm miqve specialë dhe njerëzve të shtëpisë. Për këtë gjë, Rama tha se e pranon me nderim dhe mirënjohje “Çelësin e Qytetit”. “Jam tejet i emocionuar dhe i nderuar nga pritja e ngrohtë dhe bujare e Bashkisë së

Tiranës dhe z. Erion Veliaj gjatë vizitës tonë të parë zyrtare. E pranoj me nderim dhe mirënjohje Çelësin e Qytetit, si simbol të hapjes së rrugëtimit të reja të përbashkëta që i presin të rinjtë tanë dhe qytetet tona”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Ruqiqi: Viti 2022 do të jetë i vështirë, do të ketë problem me sigurimin e fuqisë punëtore

PRISHTINË, 9 JANAR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Ruqiqi, paralajmëron se viti 2022 do të jetë shumë më sfidues sesa viti 2021 në aspektin ekonomik. Ai kërkon nga qeveria, parlamenti dhe të gjitha institucionet të jenë të hapura për dialog me sektorin privat. "Nuk do të përsëritet vera e vitit 2021, që ishte infuzioni kryesor për shumë ndërmarrje (i ardhur nga diaspora), të dërrmuara nga pandemia; Konsumi do të shënojë rënie, rrjedhimisht edhe norma e rritjes ekonomike do të jetë në rënie", ka shkruar Ruqiqi në "Facebook".

Më tej ai thotë se "ky dimër do të jetë më i 'gjatë' se të tjerët marrë parasysh problemet me furnizimin dhe çmimet e energjisë elektrike dhe çmimet e rritura në pothuajse të gjithë

lëndët e para dhe produktet finale, nga kategoritë e produkteve që ne i importojmë". "Paparashikueshmëria me pandeminë do të vazhdojë të sjellë kokëçarje për sektorin privat. Sektori privat ende nuk arrin të kuptojë çka është vlera e vaksinimit me dy dhe tre doza, nëse të njëjtat nuk garantojnë liri të veprimit dhe kryerjes të aktivitetit biznesor. Çdo masë për kontrollimin e pandemisë duhet të kufizojë të pavaksinuarit e jo ata që me shumë zell e respektuan thirrjen për vaksinim", tha ai.

Ruqiqi thotë se do të rritet problemi me fuqinë punëtore. "Mosgjetja e punëtorëve me shkathtësi të caktuara është problem në rritje për të gjithë sektorët. Nëse kjo problematikë vazhdon, ne do të kemi probleme



serioze me aftësinë konkurruese për eksport dhe investime. Qeveria, parlamenti dhe të gjitha

institucionet duhet të jenë të hapura për dialog me sektorin privat, për adresimin e këtyre

temave, por edhe shumë çështje të tjera me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit", thotë Ruqiqi.

Pse po bien çmimet e kriptovalutave?



PRISHTINË, 9 JANAR - Kriptovalutat kanë parë rënie të çmimeve ndërsa një përplasje vazhdon në disa monedha kryesore gjatë ditëve të fundit.

Ethereum, BNB e Binance, Solana, Cardano dhe XRP janë ndër më të goditurat, me 2.1 trilionë dollarë vlerë të humbur në tregun e kriptove.

Bitcoin ishte me vlerë 43,058.75 dollarë të enjten, por ra në nivelin më të ulët prej 42,496 dollarësh të premtën.

Kjo përbën një rënie prej 40-përqindësh nga niveli i saj më i lartë i të gjitha kohëve, i vendosur në nëntor në pothuajse 70 mijë dollarë, me një prirje rënësive që tani po merr një shpejtësi edhe më të madhe.

Në mënyrë të ngjashme, Ethereum ra 12 për qind në 3,411,92 dollarë dhe Solana ra 12 për qind në 148,58 dollarë.

Një nga faktorët kryesorë është se Rezerva Federale ka lënë të

kuptohet se mund të ketë një rritje të shpejtë të mundshme të normave të interesit këtë vit.

Në një takim në muajin dhjetor të zyrarëve amerikanë u diskutua mundësia për tkurrjen e bilancit prej 8.3 trilionë dollarësh.

Kjo shkaktoi shitje në tregjet e kriptove dhe të aksioneve, me NASDAQ që humbi më shumë se tre për qind, e cila rënia më e madhe që nga muaji mars i vitit të kaluar.

Me rritjen e normave të interesit, investimet e paqëndrueshme si kriptovalutat bëhen më pak tërheqëse kur krahasohen me obligacionet qeveritare për shkak të niveleve të ulëta të të ardhurave të krijuara.

Këta faktorë, të kombinuar me pasigurinë e përgjithshme të tregut të shkaktuar nga varianti Omicron i Covid-19, kanë çuar në pasiguri të madhe.

Reduktimet e energjisë elektrike, kryetari i Obiliqit paralajmëron padi ndaj KEDS-it

OBILIQ, 9 JANAR - Me Ligjin për Obiliqin kësaj komune i garantohet furnizim i rregullt me energji elektrike, por ditët e fundit reduktimet janë duke e prekur edhe këtë qytet. Është kryetari Xhafer Gashi që paralajmëron padi ndaj Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (KEDS) për shkak të reduktimeve që banorët e kësaj komune po përballen.

Si pasojë e krizës energjetike tashmë në Kosovë kanë filluar reduktimet e energjisë elektrike, por që kreu i Obiliqit thotë se si komunë prodhuese e energjisë elektrike, nuk duhet të

kenë ndërprerje. "Ka kohë pas kohë nga dy orë por, në fakt, me Ligjin për Obiliqin janë të obliguar që të furnizohet 24 orë Obiliqi me energji elektrike.

Ne kemi bërë një reagim te KEDS-i sepse e kemi diskutuar dhe kemi një marrëveshje edhe me KEDS-in. Nëse do të vazhdojë kështu ne do të jemi të gatshëm të fillojmë edhe me bizneset, por edhe me amvisërinë për dëmet që po u shkaktohen gjatë kësaj ndërprerje të energjisë elektrike dhe do të bëjmë një padi drejtpërdrejt në gjykatë", thotë Gashi.

Ai thekson se një nga projektet

më të rëndësishme që do të përfundojë gjatë këtij mandati është projekti për ngrohtoren e qytetit. "Do të jetë në faza. Faza e parë do të jetë Obiliqi, Mazgiti dhe Millosheva. Janë ndarë dy milionë buxhet për fillimin e projektit të shtrirjes së rrjetit dhe shpresoj që kjo do të jetë në vazhdimësi në katër vitet e ardhshme", thekson ai.

Përveç përfundimit të projekteve që kanë nisur gjatë mandatit të kaluar, i pari i Obiliqit thotë se përgjatë katër vjetësh do të investojnë edhe në shumë projekte të tjera në shëndetësi, arsim, infrastrukturë.

Gashi pret mbështetjen e nivelit



qendror për ta realizuar projektin e përbashkët me

KEK-un sa i përket ndërtimit të parkut të gjelbër. (kps)

Liria pa kufi është e kundërta e lirisë

Në vitin 1955, shkrimtari i madh francez Albert Camus, ka mbajtur këtë fjalim në Athinë, në një diskutim për Evropën, mes plagëve të vjetra dhe shpresave të reja: “Liria pa kufi është e kundërta e lirisë. Vetëm tiranët mund të ushtrojnë lirinë pa limite; dhe për shembull, Hitleri ishte relativisht një njeri i lirë, i vetmi në të gjithë perandorinë e tij. Por, nëse duam të ushtrojmë një liri të vërtetë, nuk mund të ushtrohet vetëm në interes të individit që e ushtron. Liria ka patur gjithmonë si kufi, lirinë e të tjerëve”

Nga: Albert CAMUS

Nëse besojmë se qytetërimi perëndimor konsiston mbi të gjitha në humanizimin e natyrës, domethënë në teknikat dhe në shkencën, Evropa jo vetëm ka triumfuar, por forcat që sot e kërcënojnë, kanë huazuar nga Evropa perëndimore teknikat dhe ambiciet e saj dhe, në çdo rast, metodën e saj shkencore apo atë të arsyetimit. I parë kështu, qytetërimi evropian nuk është i rrezikuar, përveçse nga ndonjë vetëvrasje e përgjithshme. Nëse, e anasjellta, besojmë se qytetërimi ynë është zhvilluar mbi konceptin e qenies humane, ky këndvështrim, që mund të jetë i vlefshëm, çon në një përgjigje krejt tjetër. Ndoshta është e vështirë të gjesh një epokë në të cilën numri i njerëzve të poshtëruar të ketë qenë kaq i madh. Megjithatë, nuk do të thoja që kjo epokë përçmon në veçanti qenien njerëzore. Në fakt, njëkohësisht me këto forca, që do t'i quaja të së keqes për të thjeshtësuar gjërat, nuk ka dyshim që përgjatë shekujve është përhapur në mënyrë progresive një reaksion i ndërgjegjes kolektive dhe në mënyrë të veçantë i ndërgjegjes së të drejtave individuale. Dy luftërat botërore vetëm sa e kanë lodhur pak dhe besoj se është e arsyeshme të përgjigjemi që qytetërimi ynë rrezikohet, në po të njëjtën masë sa, qenia njerëzore sot, kudo e nga pak, poshtërohet. Këtij dallimi të dobishëm mund t'i shtoj se ne ndoshta mund të ngrejmë pyetjen që, mos vallë pikërisht suksesi i qytetërimit perëndimor në aspektin e vet shkencor, është pjesërisht fajtor për dështimin moral të këtij qytetërimi? Për ta thënë ndryshe, mos vallë, në një farë kuptimi, besimi absolut, i verbër, në fuqinë e arsyes racionaliste – të themi në arsyen karteziene për të thjeshtësuar gjërat, sepse është kjo arsye në qendër të dijes bashkëkohore – është përgjegjëse në një farë

mase për kufizimin e ndjeshmërisë njerëzore që ka mundur, gjatë një procesi të gjatë për ta shpjeguar, të shkaktojë pak e nga pak këtë degradim të universit personal. Universi teknik në vetvete nuk është një gjë e keqe, dhe jam absolutisht kundër të gjithë atyre teorive që kërkojnë kthimin tek rrota, apo plugu i tërhequr nga buajt. Por arsyeja teknike, e vendosur në qendër të universit, konsideruar si agjenti mekanik më i rëndësishëm i një qytetërimi, përfundon duke provokuar një lloj perversioni, si tek intelijenca, ashtu edhe tek zakonet, që rrezikon të çojë në dështim atë për të cilin kemi folur. Do të ishte interesante të përpiqeshim të kuptonim se si e bën këtë. (...) Cilët janë, mbi të gjitha, elementët që përbëjnë qytetërimin evropian? Ju përgjigjem që nuk e di. Megjithatë, secili prej nesh ka një këndvështrim të privilegjuar, sentimental në një farë mënyre, që për më tepër mund të arsyetohet bazuar mbi vëzhgime, e që na bën të preferojmë një prej këtyre elementëve, kundrejt të tjerëve. Sipas meje, qytetërimi evropian është pikësepari një qytetërim pluralist. Dua të them që ai është vendi i diversitetit të mendimeve, të kundërshtimeve, të vlerave që bien ndesh dhe të dialektikës që nuk arrin në një sintezë. Në Evropë, dialektika e gjallë është ajo që nuk çon në një lloj ideologjie njëkohësisht totalitare dhe ortodokse. Më duket se kontributi më i rëndësishëm i qytetërimit tonë është ai pluralizëm, që ka qenë gjithmonë themeli i nocionit të lirisë evropiane. Sot, është pikërisht ky që është në rrezik dhe këtë duhet të përpiqemi të ruajmë. Shprehja e Volterit, që më duket se ka thënë se “nuk mendoj si ju, por do të luftoja deri në vdekje për t'ju lënë të shprehni mendimin tuaj” është natyrisht një parim i mendimit evropian. Nuk ka dyshim, që sot



në planin e lirisë intelektuale, por edhe në plane të tjerë, ky parim vihet në diskutim, sulmohet dhe më duket se duhet mbrojtur. Në lidhje me pyetjen, për të ditur nëse në fund do të shpëtohet dhe nëse në fund e ardhmja do të jetë e jona, siç thuhet, pikërisht këtyre lloj pyetjeve u përgjigjem në të njëjtën mënyrë siç u përgjigjem të tjerave, që i ngre vetvetes në situata të ngjashme. Në disa rrethana, më duket se një njeri mund të përgjigjet: “Kjo gjë është e vërtetë, sipas meje, apo ndoshta e vërtetë. Pra, kjo gjë duhet të jetojë. Nuk është e sigurt që unë mundem ta bëj të jetojë, nuk është e sigurt që atë që mua më duket thelbësore, nuk e pret vdekja. Sidoqoftë, e vetmja gjë që mund të bëj është që të luftoj që të mbesë e gjallë”. Mendoj se në këtë fazë Evropa është e mbyllur në një kuadër të ngurtë, në brendësi të të cilit nuk mundet të marrë frymë. Që nga momenti kur Athina është gjashtë orë nga Parisi, që në tre orë nga Roma shkohet në Paris, dhe që kufijtë ekzistojnë vetëm për doganierët dhe pasagjerët që i nënshtrohen juridiksionit të tyre, jetojmë në një shtet feudal. Evropa, që ka qenë fillesa e ideologjive që dominojnë sot botën, e që sot i sheh të kthehen kundër saj, teksa janë mishëruar në vende më të mëdhenj dhe më të fuqishëm industrialisht, kjo Evropë që ka patur pushtetin dhe fuqinë që të teorizojë ideologji të tilla, në po të njëjtën mënyrë mund të gjejë forcën për të krijuar konceptet që mund të lejojnë kontrollin apo ekuilibrimin e këtyre ideologjive. Thjeshtë ka nevojë për frymëmarrje, për mënyra të menduari që nuk janë provinciale, ndërkohë që për

momentin të gjithë mënyrat tona të të menduarit janë të tilla. Idetë pariziene janë provinciale; edhe ato athiniane, në kuptimin që kemi vështirësi të madhe për të patur kontakte dhe dije të mjaftueshme, duke qenë se idetë tona janë të izoluara në vendet respektive. E megjithatë mendoj që ky ideal, drejt të cilit të gjithë duam të shkojmë, që duhet ta mbrojmë dhe për të cilin duhet të bëjmë të pamundurën, nuk do të realizohet shumë shpejt. “Sovraniteti” për shumë kohë ka vënë shkopinj në të gjithë rrotat e historisë ndërkombëtare. Do të vazhdojë ta bëjë. Plagët e luftës janë ende shumë të hapura, shumë të dhimbshme për të shpresuar që kolektiviteti i kombeve do të bëjë atë përpjekje, të cilën vetëm individë superiorë janë në gjendje ta bëjnë, e që konsiston në dominimin e ndjenjave. Pra, psikologjikisht ndodhemi përballë pengesave që e bëjnë të vështirë realizimin e këtij ideali. Thënë kjo, duhet luftuar për të kapërcyer pengesat dhe për të bërë Evropën, më në fund Evropën, ku Parisi, Athina, Roma, Berlina do të jenë qendrat nevralgjike të një perandorie të mesme, e që do të luajë rol në historinë e të nesërme. Rezerva e vogël që do të paraqes është si vijon. Është thënë se nuk mund të përballlet nga pikëpamja intelektuale problemi i të ardhmes evropiane, që nuk mund të reflektohet deri sa nuk kemi atë strukturë të cilës mund t'i referohemi. Ajo që dua të them është: ne duhet të përballemi me problemin, t'u japim përmbajtje vlerave evropiane, edhe pse Evropa nuk do të bëhet nesër. Më goditi pak shembulli që

dëgjova. Ju thatë: “Gjermania, kur nuk ishte e bashkuar, nuk ishte një fuqi”. Është e vërtetë. Madje, duhet të themi se pjesa më e madhe e ideologjive bashkëkohore janë formuar mbi ideologjinë gjermane të shekullit XIX, dhe që të gjithë filozofët gjermanë që kanë bërë të lindë ajo formë e re mendimi, i paraprijnë bashkimit gjerman, natyrisht nëse konsiderojmë që bashkimi gjerman u realizua në 1871. Pra, është e mundur të ndikosh mbi një qytetërim, edhe në gjendjen e braktisjes dhe varfërisë ku ndodhemi. Roli i intelektualëve dhe shkrimtarëve është në një farë kuptimi ai i vazhdimit të punës në fushën e tyre, të përpiqen të shtyjën rrotën e historisë, nëse mund ta bëjnë e nëse kanë kohë.

(...) Liria pa kufi është e kundërta e lirisë.

Vetëm tiranët mund të ushtrojnë lirinë pa limite; dhe për shembull, Hitleri ishte relativisht një njeri i lirë, i vetmi në të gjithë perandorinë e tij. Por nëse duam të ushtrojmë një liri të vërtetë, nuk mund të ushtrohet vetëm në interes të individit që e ushtron. Liria ka patur gjithmonë si kufi, lirinë e të tjerëve. Dua të shtoj që ajo ekziston dhe ka një kuptim vetëm nëse limitohet nga liritë e të tjerëve. Një liri që sjell vetëm të drejta, nuk do të ishte liri, por vetëm tirani. Por, nëse sjell të drejta dhe detyrime, është një liri që ka përmbajtje dhe mund të jetojë. Pjesa tjetër, liria pa limite nuk jetojë dhe ka si cmim vdekjen e të tjerëve. Liria me limite është e vetmja gjë që bën të bashkëjetojnë atë që e ushtrojnë dhe ata në favor të të cilëve ushtrohet.

Sfidat dhe pasiguritë me të cilat do përballet ekonomia globale në vitin 2022

Nga Nouriel ROUBINI
"Project Syndicate"

Pavarësisht goditjeve që sollën variantet e reja të Covid-19, 2021-a rezultoi të ishte një vit relativisht pozitiv për ekonominë dhe tregjet në shumicën e rajoneve të botës. Ekonomia globale u rrit mbi potencialin e saj pas recesionit të rëndë që pësoi në vitin 2020, ndërsa tregjet financiare përjetuan një rikuperim të konsiderueshëm. Kjo ishte veçanërisht më e vërtetë për Shtetet e Bashkuara, ku tregjet e aksioneve arritën nivele të larta, pjesërisht për shkak të politikës monetare ultra liberale të Rezervës Federale të SHBA (ndonjëse bankat qendrore në ekonominë e tjera të përparuar, ndoqën politikat e tyre në përputhje me rrethanat).

Por viti 2022 mund të jetë më i vështirë. Pandemia nuk ka mbaruar ende. Omicron mund të mos jetë aq virulent sa variantet e mëparshme – sidomos në ekonominë e zhvilluar, ku është vaksinuar pjesa dërrmuese e njerëzve – por ai është shumë më ngjitur, gjë që do të thotë se shtrimet në spital dhe vdekjet do të mbeten në nivele të larta. Dhe pasiguria që gjeneron kjo situatë do të dëmtojë kërkesën në treg, dhe do të shtojë pengesat në zinxhirin e furnizimit. Bashkë me kursimet e tepruara, kërkesën e dobët dhe politikat liberale monetare dhe fiskale, ishin këto pengesa që nxitën një inflacion galopant në vitin 2021.

Shumë nga drejtuesit e bankave qendrore, që këmbëngulnin se rritja ekonomike e shoqëruar me një inflacion të lartë ishte diçka kalimtare, e kanë pranuar tani se kjo situatë do vazhdojë edhe për më gjatë. Me shkallë të ndryshme emergjence, ata po planifikojnë të heqin gradualisht dorë nga politikat monetare jo tradicionale si lehtësimi sasior, në mënyrë që të mund të fillojnë të normalizojnë normat bazë të interesit.

Vendosmëria e bankave qendrore, do të vihet seriozisht në provë, në rast se rritja e normës bazë do të shkaktojë tronditjen e tregjeve të obligacioneve, kredive dhe aksioneve. Me një grumbullim kaq të madh të borxhit privat dhe publik, tregjet mund të mos jenë në gjendje që të absorbojnë kostot më të larta



të huamarrjes.

Në rastin më të keq, bankat qendrore do ta gjenin veten në një kurth borxhesh, dhe ndoshta do të ndryshonin kursin e tyre. Kjo do të sillte një ndryshim në lidhje me pritshmëritë e inflacionit të mundshëm, teksa ky i fundit mund të bëhet endemik. Ndërkohë, viti i ardhshëm sjell gjithashtu me vete rreziqe gjeopolitike dhe sistematike. Në frontin gjeopolitik, duhet pasur në vëmendje 3 kërcënime kryesore. Së pari, Rusia po përgatitet të pushtojë Ukrainën, ndaj mbetet për t'u parë nëse negociatat për një regjim të ri rajonal të sigurisë, mund të parandalojnë përshkallëzimin e këtij kërcënimi.

Edhe pse presidenti amerikan Joe Biden i ka premtuar Ukrainës më shumë ndihmë ushtarake, dhe e ka kërcënuar Rusinë me sanksione më të ashpra, e ka bërë po ashtu të qartë se SHBA-ja nuk do të ndërhyjë drejtpërdrejt me trupa për të mbrojtur Ukrainën kundër një sulmi rus.

Por ekonomia ruse është bërë më rezistente ndaj sanksioneve sesa në të kaluarën. Kësaj kërcënime të tilla, mund të mos e bindin presidentin rus Vladimir Putin. Tek e fundit, disa sanksione perëndimore – si për shembull bllokimi i gazsjellësit Nord Stream 2 – mund të thellojnë mungesat

energjitike që ka sot Evropa.

Së dyti, lufta e ftohtë Kinë-SHBA po bëhet më e ftohtë. Kina po e shton presionin e saj ushtarak në Tajvan dhe në Detin e Kinës Jugore (ku ka shumë mosmarrëveshje territoriale), dhe po përshpejtohen përplasjet midis ekonomive kineze dhe amerikane. Me kalimin e kohës, kjo do të sjellë pasoja stagflacioniste.

Së treti, Irani është shumë pranë shndërrimit në një shtet me armë bërthamore. Ai e ka pasuruar me shpejtësi uraniumin deri në shkallën për të prodhuar armë, ndërsa negociatat për një marrëveshje të re apo të ripërtërirë nuk kanë çuar deri tani askund. Në këto kushte, Izraeli po shqyrton hapur mundësinë e ndërmarrjes së sulme ajrore kundër objekteve bërthamore iraniane.

Po të ndodhte kjo, pasojat stagflacioniste ka të ngjarë të jenë edhe më të rënda se krizat e ndikuara nga goditjet gjeopolitike të lidhura me naftën në vitet 1973 dhe 1979. Viti i ri vjen edhe me disa probleme sistematike. Në vitin 2021, valët e të nxehtit ekstrem, zjarret, thatësira, uraganet, përmytjet, tajfunet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, zbuluan shumë qartë pasojat e ndryshimeve klimatike në botë.

Samiti i klimës COP26 në Gllasgou prodhoi kryesisht një mal me premtime, duke e

lënë botën të shkojë me siguri drejt vuajtjes nga pasoja e një ngrohje mesatare globale prej 3 gradë Celsius deri në fund të këtij shekulli. Thatësira po shkakton tashmë një rritje të rrezikshme të çmimeve të ushqimeve, ndërsa vazhdojnë të thellohen efektet e ndryshimeve klimatike.

Për më tepër, ecja me shpejtësi drejt dekarbonizimit të ekonomive (heqjes dorë nga lëndët djegëse fosile, dhe përdorimin e burimeve të pastra energjitike), po çon në investime të pamjaftueshme mbi kapacitetin e karburanteve fosile, përpara se të ketë një furnizim të mjaftueshëm me energji të rinovueshme.

Kjo dinamikë, do të sjellë me kalimin e kohës çmime shumë më të larta të energjisë. Nga ana tjetër, flukset e refugjatëve, që braktisin vendlindjen për shkak të ndryshimeve klimatike, drejt SHBA-së, Evropës dhe ekonomive të tjera të përparuar do të rriten, edhe pse këto vende po i mbyllin kufijtë e tyre.

Në këtë sfond, po shtohen krizat politike si në ekonominë e përparuar ashtu edhe në tregjet në zhvillim. Zgjedhjet e mesit të mandatit në SHBA në vjeshtën e vitit 2022, mund të ofrojnë një shembull paraprak të krizës së madhe kushtetuese, që mund të pasojë zgjedhjet presidenciale

të vitit 2024.

SHBA-ja po përjeton nivele thuajse të paprecedenta të polarizimit politik, ngërçeve institucionale dhe radikalizmit. Partitë populiste (të të djathtës ekstreme dhe të së majtës ekstreme) po forcohen në mbarë botën, madje edhe në rajone si Amerika Latine, ku populizmi ka një histori të errët.

Në Peru dhe Kili u zgjodhën këtë vit liderë të së majtës radikale, Brazili dhe Kolumbia mund të ndjekin këtë shembullin në vitin 2022. Ndërsa Argjentina dhe Venezuela do të mbeten në rrugën drejt rrënimit të tyre financiar.

Normalizimi i normave të interesit nga Rezerva Federale në SHBA, dhe banka të tjera të qendrore, mund të shkaktojë goditje të forta financiare në këto dhe tregje të tjera të brishta në zhvillim si Turqia dhe Libani, për të mos përmendur shumë vende në zhvillim me borxhet që janë që tani problematike.

Ndërsa viti 2021 po i afrohet fundit, tregjet financiare "lundrojnë" në ujëra të trazuar. Aksionet e kompanive publike dhe private janë më të shtrenjta, çmimet e pasurive të paluajtshme janë shumë të larta në SHBA dhe në shumë ekonomi të tjera.

Norma e interesit për obligacionet e qeverive, mbeten shumë të ulëta, ndërsa diferenca me normën e kredive është rritur pjesërisht, për shkak të mbështetjes direkte dhe indirekte nga bankat qendrore. Për sa kohë që bankat qendrore zbatonin politika jo konvencionale, festa mund të vazhdonte.

Por "fluskat" mund të shfryhen në vitin 2022, kur të fillojë normalizimi i politikave monetare. Për më tepër, inflacioni, rritja më e ngadaltë ekonomike dhe rreziqet gjeopolitike dhe sistematike, mund të krijojnë kushtet për një korrigjim të tregut në vitin 2022. Sido që të ndodhë, investitorët ka të ngjarë të qëndrojnë në kufijtë e aseteve të tyre për pjesën më të madhe të vitit të ardhshëm.

Shënim: Nouriel Roubini, profesor i ekonomisë në Shkollën e Biznesit të Universitetit të Nju Jorkut. Ai ka punuar më herët në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Rezervën Federale të SHBA-së dhe Bankën Botërore.

Konfliktet që duhen vëzhguar me kujdes gjatë vitit 2022

Nga Comfort Ero & Richard ATWOOD
"Foreign Policy"

Pas një viti që solli sulmin mbi Capitol Hill në SHBA, një gjakderdhje të tmerrshme në Etiopi, triumfin e talebanëve në Afganistan, përballjes midis fuqive të mëdha mbi Ukrainën dhe Tajvanin, Covid-19, dhe një emergjence të klimës, është e lehtë të thuhet se bota ka dalë nga binarët.

Por ndoshta dikush mund të argumentojë se gjërat, janë në fakt më mirë nga sa duken. Tek fundit, sipas disa standardeve, luftërat janë në tërheqje e sipër. Edhe numri i njerëzve të vrarë në luftime në mbarë botën ka rënë që nga viti 2014. Dhe pavarësisht se presidenti rus Vladimir Putin po kërcënon Ukrainën, shtetet hyjnë rrallë në luftë kundër njëra-tjetrën. Teksa po shtohen konfliktet lokale, ato priren të jenë me një intensitet më të ulët. Në pjesën më të madhe, luftërat e shekullit XXI-të janë më pak vdekjeprurëse se paraardhësit e tyre të shekullit të XX-të. Gjithsesi, gjërat ende duken keq. Dhe lista e këtij viti e konflikteve nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, tregon se disa prej tyre kanë potencialin të përshkallëzohen shumë lehtë.

Ukrainë

Nëse Rusia, që ka grumbulluar mijëra trupa në kufi me Ukrainën, do të pushtojë sërish fqinjën e saj, kjo mbetet e paqartë. Por shpërfillja e kërcënimeve si bluf, do të ishte një gabim i rëndë. Përmes këtij grumbulli trupash, Rusia mund të synojë të marrë lëshime të tjera nga Perëndimi.

Por duke pasur parasysh historikun e Putinit, dhe nënvlerësimin e armiqësisë që frymëzon Moskë tek ukrainasit, jashtë zonave të kontrolluara nga separatistët, askush nuk duhet të përjashtojë një aventurë tjetër ushtarake. Nëse Rusia planifikon të luftojë, opsionet e saj variojnë nga mbështetja e kufizuar e separatistëve, tek një sulm në shkallë të plotë.

Fuqitë perëndimore, duhet ta bëjnë të qartë se çfarë do të bëjnë për të mbështetur Ukrainën, t'ia transmetonin këtë Moskës, dhe t'i përmbahen fort vijave të kuqe. Joe Biden, që do të takojë kokë më kokë Putinin në fillim të janarit, ka kërcënuar Rusinë me sanksione të forta, dhe me



një grumbullim të madh ushtarak në krahun lindor të NATO-s.

Afganistan

Nëse viti 2021 mbylli një kapitull të tragjedisë së gjatë disa dekadëshe të Afganistanit, po nis tashmë një kapitull tjetër. Që nga marrja e pushtetit nga talebanët në gusht, në vend është shfaqur një katastrofë humanitare. Të dhënat e OKB-së tregojnë se miliona fëmijë afganë mund të vdesin nga uria.

Qeveria e re nuk mundet të paguajë nëpunësit civilë. Ekonomia ka rënë, ndërsa talebanët përballen me një luftë të egër kundër degës lokale të Shtetit Islamik. Regjimi i ri ka bërë pak për të fituar simpatinë e donatorëve. Por perëndimorët kanë përgjegjësinë të madhe për gjendjen e vështirë të afganëve.

Ndërprerja e papritur e fondeve për një shtet tërësisht të varur nga ndihma, ka qenë tejet shkatërruese. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se 23 milionë njerëz, më shumë se gjysma e popullsisë, do të vuajnë këtë dimër nga uria. Katastrofën mund ta shmangë vetëm ndihma humanitare.

Shtetet e Bashkuara dhe Kina

Në Uashington, një nga pikëpamjet e pakta mbi të cilin ka një konsensus të gjerë, është se Kina është një kundërshtar me të cilin Shtetet

e Bashkuara janë një në mosmarrëveshje të pashmangshme. Konkurrenca me Kinën po bëhet një prioritet për politikën amerikane.

Strategjia e Joe Biden për Kinën, i sheh kostot e përparësisë rajonale kineze si më të rënda, sesa rreziku i përplasjes më të. Kur avionët amerikanë dhe kinezë u përplasën në vitin 2001 gjatë një periudhe raportesh të qeta midis Pekinit dhe Uashingtonit, u deshën muaj të tërë diplomacie intensive për të zgjidhur konfliktin. Sot kjo gjë do të ishte më e vështirë, dhe rreziku i përshkallëzimit është shumë më i madh.

Irani kundër SHBA-së dhe Izraelit

Ndërsa po zbehen shpresat për ringjalljen e marrëveshjes bërthamore me Iranin, po afrohet një tjetër përshkallëzim i situatës. Administrata e Joe Biden humbi shumë kohë me atë se kush duhet të bënte lëvizjen e parë, edhe pse për disa muaj, bisedimet e Vjenës shënuan hapa para.

Por në qershor, Ebrahim Raisi fitoi zgjedhjet presidenciale në Iran, duke i dhënë forcave të vijës së ashpër kontrollin e të gjitha qendrave kryesore të pushtetit të Republikës Islamike. Pas një pauze 5-mujore, Irani u rikthye tek bisedimet, por i shtoi kushtet për arritjen e një marrëveshje. Tani ka 2 opsione: diplomatët mund të përpiqen të arrijnë një marrëveshje më

gjithëpërfshirëse, ndërkohë që prishja e negociatave është një mundësi reale. SHBA-ja dhe Izraeli mund të sulmojnë nga ajri bazat iraniane, ndërsa duke mos pasur se çfarë të humbë, Teherani mund të nxitojë të armatoset me shpjetësi, dhe ka ngjarë të sulmojë objektiva në gjithë Lindjen e Mesme.

Jemen

Lufta e Jemenit nuk u shfaq shumë në mediat botërore gjatë vitin 2021, por ajo mbetet shumë shkatërruese, dhe situata atje mund të jetë gati të përkeqësohet. Rebelët Huthi kanë rrethuar rajonin e Maribit, që është shumë i pasur me naftë dhe gaz. Të nënvlerësuar prej kohësh si një forcë ushtarake, rebelët duket se po drejtojnë një fushatë të shkathët dhe në zhvillim të shumëfishtë, duke kombinuar sulmet me shtrirjen e ndikimit për të zbutur rezistencën e udhëheqësve fisnorë lokalë.

Izrael-Palestinë

Vitin që po lëmë pas u zhvillua luftën e katërt dhe më shkatërruese Gaza-Izrael në pak më shumë se një dekadë, gjë që ilustroi sërish se procesi i paqes realisht ka vdekur, dhe një zgjidhje me dy shtete duket më pak e mundur se kurrë më parë.

Qendra e gravitetit në politikën izraelite është larguar prej kohësh nga paqja, pasi qeveritë e njëpasnjëshme kanë braktisur bisedimet në të gjitha aspektet. Edhe shumica

e palestinezëve kanë humbur besimin se do të fitojnë pavarësinë përmes negociatave.


Izraeli ka disa mënyra për të blerë qetësinë e palestinezëve: një armëpushim afatgjatë dhe hapja e Gazës; apo dhënia fund e debimeve të palestinezëve në Jerusalemin Lindor. Por këto lëvizje mund të shmangin vetëm përkohësisht luftën e ardhshme midis palëve.

Militantizmi islamik në Afrikë

Që nga viti 2017, kur Shteti Islamik e humbi të ashtuquajturin kalifat në Lindjen e Mesme, Afrika ka përjetuar disa nga betejet më të egra në botë midis shteteve kombëtare dhe xhihadistëve. Si në Malin Verior, Niger, Nigeri dhe Burkina Faso. Edhe frontet më të reja xhihadiste të Afrikës – në veri të Mozambikut, dhe në lindje të Republikës Demokratike të Kongos – janë po ashtu shqetësuese. Qasja kryesisht ushtarake ndaj këtyre lëvizjeve, ka shkaktuar kryesisht më shumë dhunë. Në rast se fuqitë e huaja nuk duan që t'i përndjekë e njëjta dilemë pas një dekade, ata duhet të përgatisin terrenin për bisedime me udhëheqësit e këtyre lëvizjeve.

Marrë me shkurtime

Shënim: Comfort Ero, presidenti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Richard Atwood, nënkryetar ekzekutiv i Grupit Ndërkombëtar të Krizave.



Basha: Synoj të shkoj larg si trajner



Tiranë, 9 janar - Ish-futbollisti i njohur i Kombëtares, Migjen Basha, i ka hyrë tashmë karrierës së trajnerit, teksa është bërë pjesë e edicionit të radhës të kursit të licencimit për trajnerë të nivelit UEFA A, që është niveli i dytë për nga rëndësia pas licencës UEFA PRO.

Ish-mesfushori kuqezi është mjaft entuziast për këtë rrugëtim të ri në karrierën e tij, ndërsa vlerëson shumë punë që po bëhet për këtë program arsimor me një kurrikulë të mirëpritur nga FShF-ja në bashkëpunim me UEFA-n. Në intervistën e dhënë për Fshf.org, Migjen Basha tregon se si e sheh kursin deri tani si flet për synimet që ai ka në të ardhmen, duke mos fshehur edhe ëndrrën që një ditë të ketë mundësinë të bëhet trajner i njohur, mbase edhe i Kombëtares. "Deri në këtë moment kursi ka qenë vërtet shumë interesant, sepse nuk kemi biseduar vetëm sa i përket anës teknike dhe taktike, pasi në momentin që ke dëshirën dhe objektivin të bëhesh

trajner profesionist duhet të dish edhe shumë aspekte të tjera. Aktualisht kemi punuar me pjesën teorike dhe në vazhdim besoj se do të punojmë edhe me pjesën praktike në fushën e lojës. Është me rëndësi që të diskutojmë për disa aspekte, që ndoshta kur kam qenë futbollist asokohe nuk i kisha problem, sepse mendoja për lojën në fushë dhe në momentin që kalon në rolin e trajnerit fillojnë shumë e më shumë probleme. Duhet të bisedosh me drejtuesit, ke 25 lojtarë me të cilët duhet të diskutosh çdo gjë, me stafin teknik, mjekësor etj., por besoj se me kalimin e kohës do t'i arrijmë të gjitha qëllimet", ka thënë Basha. "Besoj se është një licencë shumë me vlerë, sepse momenti kur je anëtar i UEFA-s duhet të kesh trajnerë kompetentë dhe kjo është një punë shumë e mirë që po bëhet këtu në Shqipëri sepse, pavarësisht prej Superiores, edhe në Kategorinë e Parë duhet të jenë trajnerë të formuar dhe, siç e thashë, në

çdo aspekt duhet të jenë të gatshëm, sepse ndoshta një ditë do të ketë edhe trajnerë shqiptarë që mund të kenë ambicie për t'u transferuar jashtë Shqipërisë dhe të bëhen trajnerë të njohur përtej kufijve", ka shtuar Basha, i cili ka folur edhe për synimet që ka për të ardhmen. "Kam filluar në një kategori të ulët në Zvicër për momentin dhe kur të pajisem me licencën UEFA A, atëherë besoj se me një licencë të tillë mund të hapen dyert më lehtë dhe ke më shumë mundësi në nivele më të larta. Duhet punuar shumë që të kesh dhe mundësinë të drejtosh një skuadër më të mirë në nivele më të larta. Synimet janë të shumta. Së pari, dua që të kem licencën e trajnerit UEFA A për ta pasur më të lehtë të ec si trajner dhe pastaj dua të vazhdoj me licencën UEFA Pro, që është maksimalja në fushën e trajningut. Dhe ky është synimi im, siç kemi të gjithë synime dhe objektiva, shpresoj që në një të ardhme të mund të jem edhe trajner i kombëtares", ka deklaruar Basha.

Kosova sërish mposhtet nga Greqia

PRISHTINË, 9 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është mposhtur edhe në udhëtim nga Greqia në fazën e parë të kualifikimeve për Kampionatin Botëror të vitit 2023. "Dardanët" u mposhtën me rezultat 26:25, duke u reguar të pafuqishëm



në fund të ndeshjes. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 14:9 për Greqinë, teksa ishte deri në 10 pikë disavantazh. Më pas, Kosova u rikthye, por nuk pati fuqi që të bënte më shumë. Edhe në ndeshjen e parë në Prishtinë Kosova u mposht nga Greqia me rezultat të ngushtë 20:21.

SHKURT

Haxhijaj paraqitet te KF Onix

Klubi i Futbollit KF Onix ka arritur marrëveshje me portierin e njohur Visar Haxhijaj. Lajmi është dhënë në faqen zyrtare të klubit në "Facebook". Haxhijaj u paraqit në ambientet e klubit nga Banja e Pejës. Portieri së fundi ishte pjesë e KF Drenica. "Siç raportuam më herët, tanimë është arritur marrëveshja me portierin Visar Haxhijaj. Visari është një emër i njohur dhe me përvojë në futbollin e Kosovës. ishte pjesë e shumë klubeve të Superligës. Ne i urojmë mirëseardhje dhe i dëshirojmë suksese në klubin tonë!", thuhet në njoftimin e KF Onix.

Zielinski infektohet me Covid-19

Napoli ka njoftuar se mesfushori polak Piotr Zielinski ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lajmi është dhënë në faqen zyrtare të klubit. "Pas raundit të tamponëve të kryer këtë pasdite për grupin e ekipit, doli pozitiviteti i Piotr Zielinski ndaj Covid-19", thuhet në njoftimin e klubit. Lojtari është i vaksinuar dhe nuk ka simptoma. Ai ka ndjekur protokollin mjekësor dhe është vetizoluar në shtëpi.

Murray: Drama e Djokoviçit nuk është aspak e mirë për tenis

Andy Murray thotë se ai është i tronditur nga situata e Novak Djokoviçit për të fituar hyrjen në Australi, duke thënë se "me të vërtetë nuk është aspak e mirë për tenis". Djokoviçit iu mohua hyrja në vend pasi mbërriti për shkak të rregullave të vaksinave dhe tani po apelon kundër deportimit. Numri një në botë aktualisht ndodhet në një qendër imigracioni. "Unë mendoj se të gjithë janë të tronditur nga kjo", ka thënë Murray, i cili, gjithashtu, do të luajë në turneun i cili fillon më 17 janar. "Unë do të them dy gjëra për këtë vetëm tani. Gjëja e parë është se shpresoj që Novak të jetë mirë. E njoh mirë dhe kam pasur gjithmonë një marrëdhënie të mirë me të dhe shpresoj që ai të jetë mirë. Gjëja e dytë: me të vërtetë nuk është aspak e mirë për tenis dhe nuk mendoj se është e mirë për askënd. Mendoj se është shumë keq", ka deklaruar Murray. Seanca gjyqësore e Djokoviçit do të fillojë të zhvillohet të hënën pasi një ofertë nga qeveria australiane për ta vonuar apelimin e tij kundër deportimit u refuzua.

Ronaldo kërkon largimin nga Unitedi

Periodha e dytë e Cristiano Ronaldos te Manchester Unitedi mund të marrë fund pas vetëm një sezoni. Portugezi u kthye në "Old Trafford" nga Juventus verën e kaluar, ku vendosi të largohej pasi kishte filluar sezoni 2021/22. Tani, në mes të të njëjtit sezon, ai po mendon një largim nga Manchester Unitedi. Sipas "The Sun", Cristiano ka thirrur agentin Jorge Mendes për të zhvilluar "bisedime për krizën", duke bërë që Mendes të fluturojë për në Manchester për t'u takuar me klientin e tij.

Emërimi i Ralf Rangnick si trajner i përkohshëm pas shkarkimit të Ole Gunnar Solskjaer nuk ka pasur ndikimin e dëshiruar dhe thuhet se ka lënë një numër lojtarësh të pakënaqur, mes të cilëve edhe Cristianon. "Cristiano është shumë i shqetësuar për atë që po ndodh në United", ka thënë një burim i afërt me lojtarin për "The Sun". "Ekipi po merr shumë kritika dhe ai e di se ai konsiderohet si një nga liderët. Ka mjaft probleme dhe Cristiano po ndien presionin dhe është shumë i stresuar nga situata. Ai dëshiron dëshpërimisht që lëvizja e tij në United të jetë një sukses, por ai ka filluar të kuptojë se fitimi i trofeve me formacionin aktual mund të jetë një luftë e vërtetë. Jorge erdhi për ta parë atë dhe ata kaluan kohë duke biseduar se si po shkojnë gjërat, çfarë mendojnë ata janë problemet, si mund të zgjidhen dhe cilat mund të jenë zgjidhjet. Asgjë nuk përjashtohet". Numri 7 ka 14 gola në të gjitha kompeticionet këtë sezon.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Koca Law Office" L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811861097 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Koca Law Office" L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr: 811861097 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Koca Law Office" L.L.C. Pristine. has come to the decision to quit its business: 811861097 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Agnesa Smajli shpalle të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme SHMLM. "Dr. Xheladin Deda" dhe certifikatën e maturës.

► Isak Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Marsi" Prishtinë.

► Azar Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor" Lubinje e Epërme ".

► Kreshnik Tejeci shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Leke Dugagjini " Prizren.

► Armend Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Abdyl Frasherit " Prizren.

► Fevrije Beka, shpalle te pavlefshme certifikatën e statusit martesor.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

